

VENDIM
Nr.366, datë 22.8.1992

**PËR FITIMET SPEKULATIVE TË REALIZUARA NGA ZBATIMI I ÇMIMEVE ME TË
LARTA NGA ATO TË CAKTUARA NGA KËSHILLI I MINISTRAVE**

Në zbatimin e nenit 8 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 "Për çmimet dhe tarifat", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Fitimet spekulative të realizuara nga zbatimi i çmimeve më të larta nga ato të miratuara nga Këshilli i Ministrave, derdhen 85 për qind në buxhetin e shtetit dhe 15 për qind në buxhetin e rrethit përkatës ku kapet shkelja.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi